



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRN

02 Nr. / Br 542/21

Nr. i fq. / Br. sf -07-

Data: / Datum 17.05.2021

VUSHTRRI - VUČITRN

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE
NPL PËRPARIMI SH.A - VUSHTRRI
Nr: Protokolit: 14/21
Data: 17.05.2021

Komuna Vushtri

NPL "Përparimi" SH.A – Vushtri

Bazuar në nenin 9 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, nenin 17, pika (f) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 79, shkronja "e", "h", "i", "q", "s" të Statutit të Komunës, Vendimin e Kuvendit të Komunës 01Nr.129/19 datë 25.04.2019 për krijimin e Ndërmarrjes Publike Lokale "Përparimi" SH.A, më datën 17.05.2021, arrihet kjo:

**MARRËVESHJE
PËR KRYERJE TË SHËRBIMEVE KOMUNALE NË KOMUNËN E
VUSHTRRISE**

Në mes të:

- Komunës së Vushtrrisë, përfaqësuar nga **Z. Xhafer Tahiri**, Kryetar (në tekstin e mëtejme Komuna) dhe
- Ndërmarrjes Publike Lokale "Përparimi" SH.A Vushtri, përfaqësuar nga **Z. Fadil Bahtiri**, Kryeshef Ekzekutiv, (në tekstin e mëtejme Ndërmarrja)

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i marrëveshjes është:

1. Përcaktimi i shërbimeve të cilat NPL "Përparimi" SH.A ia ofron komunës në bazë të standardeve të kërkuara, mënyrën e ofrimit, operimit dhe menaxhimit të këtyre shërbimeve.
2. NPL "Përparimi" SH.A dhe komuna pajtohen që t'i kryejnë obligimet e specifikuar në këtë marrëveshje si: kryerjen cilësore të shërbimeve publike duke përfshirë specifikimet e shërbimeve, monitorimin e performancës së kryerjes së shërbimeve si dhe raportimin.

**Neni 2
Kohëzgjatja e Marrëveshjes**

Kjo Marrëveshje vlen për periudhën kohore 17.05.2021 deri më 16.05.2022.

Neni 3 Shërbimet që i ofron NPL “Përparimi”

NPL “Përparimi”, sipas kësaj marrëveshje i kryen shërbimet e shënuara si në vijim:

1. Menaxhimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike komunale që nënkupton:

- 1.1 Kositjen e të gjitha hapësirave publike të gjelbëruara (parqeve etj.) duke përfshi edhe varrezat e qytetit (varrezat e konservuara dhe ato aktuale) hapësirat përreth/ngjitas me varrezat e dëshmorëve, martirëve, lapidareve, pllakave përkujtimore përmendoreve etj. të cilat menaxhohen nga komuna, në sipërfaqe të përgjithshme prej 134.100 m².
Çmimi për m² është 0.09 euro.
- 1.2 Krasitjen e drunjëve dekorativ së paku një herë në vit.
Çmimi për një copë (dru dekorativ) është 2.30 euro
- 1.3 Mbjelljen e luleve në vende të caktuara, të kërkuara paraprakisht nga Drejtoria e Shërbimeve Publike.
Çmimi për një copë (fidan i luleve) është 0.08 euro
- 1.4 Mbjelljen e barit artificial në hapësirat publike të kërkuar paraprakisht nga Drejtoria e Shërbimeve Publike.
Çmimi për m² është 1.30 euro.
- 1.5 Ujitjen e drunjëve dekorativ dhe luleve.
Çmimi për copë është 0.50 euro

2. Mirëmbajtjen - pastrimin e objekteve të institucioneve publike të komunës, (objektet e Arsimit, Shëndetësisë dhe Administratës së Komunës) që nënkupton:

- 2.1 Kryerjen e shërbimeve të pastrimit të të gjitha hapësirave të 3 shkollave të arsimit të mesëm, dhe arsimit parashkollor, si dhe objektet përcjellëse të tyre.
- 2.2 Kryerjen e shërbimeve të pastrimit të të gjitha hapësirave të Qendrës së Mjekësisë Familjare në Rugën “Dëshmorët e Kombit” në qytet.
- 2.3 Kryerjen e shërbimeve të pastrimit të të gjitha hapësirave të objekteve të Administratës së Komunës – Objekti i Komunës si dhe objektet tjera të administratës komunale jashtë objektit të komunës (Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, Qendra e Kulturës “Hasan Prishtina” Palestra Sportive në Vushtrri, ajo në Samadrexhë, Muzeu i Qytetit dhe Qendra Rinore “Naxhije dhe Fahri Buqinca” .
- 2.4 Pastrimi përfshinë: Pastrimin e zyrave dhe inventarit, pastrimin e korridoreve, shkallëve, tualeteve, dritareve dhe sipërfaqeve para hyrjeve të objekteve të cekura më sipër për pastrim.
- 2.5 Pastrimi duhet të bëhet një herë në ditë pas përfundimit të orarit të punës në administratë përkatësisht përfundimit të orarit të mësimi në shkollë.
- 2.6 Gjithashtu duhet të caktohet nga një pastrues/e kujdestar për intervenime në objektet e cekura në nënpikën 2.1, 2.2 dhe 2.3, në rast të paraqitjes së nevojës për pastrim.
- 2.7 Për shërbimet e kryera si në nënpikat 2.1, 2.2 dhe 2.3, Komuna do të paguaj mjete financiare nga buxheti i Drejtorisë për Shërbime Publike si vijon:
njëzetënjëmijëetreqindpesëdhjetë euro (21,350.00 €) në muaj.

2.8 Në shërbimin e pastrimit duhet të angazhohen 61 punëtorë/e pastrues/e, të cilët do të sistemohen:

- në objektet e administratës së komunës, 21 punëtorë/e,
- në tri shkollat e mesme, 27 punëtorë/e,
- në Qendrën e Mjekësisë Familjare në qytet 11 punëtorë/e dhe
- në Qendrën për Punë Sociale, 2 punëtorë/e.

3. **Sigurimin fizik të objekteve të institucioneve publike të komunës** (objektet e Arsimit, Shëndetësisë dhe Administratës së Komunës), që nënkupton:

3.1 Sigurimin fizik të të gjitha objekteve arsimore (shkollat dhe objektet përcjellëse),

3.2 Sigurimin fizik të objektit shëndetësor dhe objektet përcjellëse, (QMF në qytet, Qendrën për Punë Sociale dhe Qendrën Rezidenciale në Lumadh),

3.3 Sigurimin fizik të objekteve të administratës së komunës dhe objektet përcjellëse.

3.4 Për shërbimet e kryera si në nënpikat 3.1, 3.2 dhe 3.3, Komuna do të paguaj mjete financiare nga buxheti i Drejtorisë për shërbime publike si vijon: **njëzet e katërmijë e pesëqind euro (24,500 €)** në muaj.

3.5 Në shërbimin e sigurimit fizik duhet të angazhohen 70 punëtorë të cilët do të sistemohen:

- në objektet e administratës së komunës 14 punëtorë,
- në objektet shkollore 49 punëtorë,
- në Qendrën e Mjekësisë Familjare në qytet Rr. "Dëshmorët e Kombit" 3 punëtorë,
- në Qendrën për Punë Sociale 3 punëtorë dhe
- në Qendrën Rezidenciale në Lumadh 1 punëtor.

Neni 4

Faturimi dhe pagesa

1. Komuna do të kryej pagesat në baza mujore për shërbimet e kryera në llogarinë bankare të NPL "Përparimi" SH.A, nr. 1707017600221853 NLB Bank.
2. Pagesa do të bëhet pas pranimi të faturës nga NPL "Përparimi" SH.A dhe raportit të aprovuar të organit mbikëqyrës.
3. Dorëzimi i faturës dhe raportit të organit mbikëqyrës për punëtor të mirëmbajtjes – pastrimit dhe punëtorëve të sigurimit fizik duhet të bëhet me datën 01 të secilit muaj pas kryerjes së shërbimit ndërsa pagesa në llogari të kryesit të shërbimeve do të bëhet më së largu deri me datën 05 të secilit muaj.
4. Nëse data 01 ose 05 korrespondon me ditë pushimi, atëherë pagesa bëhet në ditën e parë pasuese të punës.
5. Nëse NPL "Përparimi" vonon dorëzimin e faturës për shërbimin e kryer pas datës 5 të muajit pasues, atëherë pagesa e shërbimit do të shtyhet për aq ditë sa është vonuar dorëzimi i faturës.
6. Pagesa për shërbimet e kryera si në nenin 3 paragrafi 1 i kësaj marrëveshje do të bëhet pas pranimi të faturës dhe raportit të organit mbikëqyrës.

7. NPL "Përparimi" ia ofron komunës sipas nevojës një regjistër të azhurnuar të faturave që janë lëshuar dhe pagesave që janë pranuar, të ndara sipas llojeve të shërbimit.

Neni 5

Përgjegjësitë tjera të NPL "Përparimi"

1. NPL "Përparimi" siguron tërë personelin dhe pajisjet e nevojshme për të ofruar një shërbim të kënaqshëm, në mënyrë që të jetë në përputhje me specifikacionet e shërbimit që janë përfshirë në këtë Marrëveshje.
2. NPL "Përparimi" do të sigurohet që të gjitha faturat për shërbimet e kryera do të dorëzohet me kohë te Komuna e Vushtrrisë.
3. Të jetë përgjegjës për pagesën e të gjitha çështjeve financiare, duke përfshirë pagesat e pagave për staf, të ardhurave dhe tatimet tjera, kontributet e sigurimit ose taksat e çfarëdo lloji që ndërlidhen me të punësuarit në këtë ndërmarrje, apo që burojnë nga ai punësim ose që ndërlidhen me funksionimin e ndërmarrjes.
4. Të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha pajisjeve që përdoren në lidhje me ofrimin e shërbimeve të përshkruara në këtë marrëveshje.
5. Të jetë përgjegjës për të siguruar kushtet e nevojshme për mbrojtje në punë, me të cilat sigurohet mbrojtja e jetës dhe e shëndetit të të punësuarve në pajtim me ligjin.
6. Secili punonjës mban veshur rroba që janë të pastra për aq sa i lejojnë rrethanat si dhe rroba mbrojtëse personale, siç janë jelekët me dukshmëri të lartë, dorëzat e punës dhe sipas nevojës çizmet e helmetat e sigurisë.
7. Staf i operativ i sigurimit fizik të objekteve mban veshur uniforma derisa është në detyrë.
8. Të gjitha automjetet që do të përdoren për shërbime duhet të jenë operacionale, të pastra dhe në rregull, të ngjyrosura me të njëjtën ngjyrë dhe ta bartin logon apo shenjën e identifikimit të NPL "Përparimi".
9. NPL "Përparimi" sipas nevojës apo kërkesës së komunës do të ketë autorizim me shkrim që të kontrollojë të gjitha veturat, njerëzit, çantat dhe gjësendet tjera para se të dalin apo të hyjnë në objekt apo pronën të cilën e ka nën përkujdesje.
10. NPL "Përparimi" do të mbajë përgjegjësi vetëm për pasurinë që është brenda zonës së përgjegjësisë së tij, sipërfaqen që është e kufizuar me portë, rrethojë apo sipërfaqe e ndriçuar.
11. NPL "Përparimi" nuk mban përgjegjësi për humbje apo dëmtim si pasojë e ngjarjeve që paraqiten jashtë mundësisë së vet të arsyeshme për t'i kontrolluar, duke përfshirë trazirat, luftën, terrorizmin, sulmet e armatosura, dridhjet e tokës, si dhe fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera të parapara me ligj.

Neni 6

Obligimet tjera të paparapara

1. NPL "Përparimi" siguron numër adekuat të punonjësve me shkathtësinë dhe trajnimin e duhur për t'i kryer shërbimet sipas kësaj Marrëveshje.
2. Në rast të paraqitjes së nevojave për shtim të numrit të punëtorëve të mirëmbajtjes/pastrimit apo të punëtorëve të sigurimit fizik për kryerje të shërbimeve ndaj komunës, do të bëhet pagesë shtesë e mjeteve nga buxheti i komunës në llogari të NPL "Përparimi" në bazë të kriterëve të njëjta të pagesave, për shërbime shtesë që do të kryhen.

3. Vlerësimin e nevojave për rritje të numrit të punëtorëve siç është cekur në pikën paraprake të kësaj marrëveshje e bën përfaqësuesi i komunës (menaxheri/mbikëqyrësi i kësaj marrëveshje) në koordinim me përfaqësuesin e NPL “Përparimi”.

Neni 7 **Nënkontraktimi**

NPL “Përparimi” në asnjë rast nuk mund të hyj në marrëdhënie nënkontraktimi me ndonjë nënkontraktor tjetër për kryerjen e shërbimeve të përcaktuara në këtë marrëveshje.

Neni 8 **Përgjegjësitë e komunës**

1. Komuna do të kryej pagesat për shërbimet e kryera nga NPL “Përparimi” në mënyrën dhe kushtet e përcaktuara në nenin 4 të kësaj marrëveshje.
2. Komuna cakton një komision prej tre anëtarësh për mbikëqyrje të realizimit të kësaj marrëveshje, përsa i përket shërbimeve të pastrimit të objekteve publike të komunës si dhe sigurimit fizik. Komisionin e përbëjnë: nga një zyrtar nga administrata e komunës, arsimit dhe shëndetësia.
3. Komisionet nga pika dy dhe tre e këtij vendimi caktohet me vendim të kryetarit të komunës pas marrjes së propozimeve nga drejtoritë përkatëse.
4. Komuna ka të drejtë poashtu t’i inspektojë në çdo kohë lokacionet e parapara në këtë marrëveshje në të cilat i kryen shërbimet nga NPL “Përparimi” performancën për shërbimet e kryera, zbatimin e standardeve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar në këtë marrëveshje.

Neni 9 **Fuqia madhore**

1. Nga NPL “Përparimi” nuk do të kërkohet që t’i kryejë shërbimet që janë saktësuar në neni 3 si më lart nëse pengohet për ta bërë këtë nga ndonjë fuqi madhore.
2. Me termin “Fuqi madhore” brenda kësaj marrëveshje nënkuptojmë një ngjarje që është përtej kontrollit të arsyeshëm të një pale, e cila shkakton pamundësinë e përmbushjes së detyrimeve të palës në këtë kontratë ose është jopraktike dhe konsiderohet e pamundur për shkak të rrethanave të krijuara. Ajo përfshin, luftën, protestat e dhunshme, mosbindjen civile, tërmetin, zjarrin, shpërthimet, stuhitë, përmytjet, etj.
3. Fuqia madhore nuk përfshin një ngjarje e cila shkaktohet nga neglizhenca apo veprimi me qëllim i një palë apo agjentëve ose punëmarrësve të saj; asnjë ngjarje të cilën një palë e kujdesshme në mënyrë të arsyeshme duhet ta kishte marrë parasysh në kohën e nënshkrimit të kësaj marrëveshje dhe që mund të ishte shmangur ose tejkaluar me përmbushjen e detyrimeve në këtë kontratë.

Neni 10 **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Kontestet që ndërlidhen me shërbimin e ofruar dhe të paguar në kuadër të kësaj marrëveshje zgjidhen në radhë të parë, gjatë takimeve kontaktuese operative të rregullta.

Çdo çështje që ka të bëjë me shërbimet e ofruara apo standardet e përshkruara në këtë marrëveshje dhe që mbetet e pazgjidhur pasi të jetë trajtuar fillimisht duhet të shkallëzohet si vijon:

1. **Niveli i parë:** Nëse çështja mbetet e pazgjidhur, ankesa/t duhet t'i parashtrihen me shkrim bordit të drejtorëve të NPL "Përparimi", anëtarët e të cilit do ta shqyrtojnë çështjen brenda 5 ditëve të punës. Nëse çështja është e ndërlikuar dhe nuk është e mundur që të zgjidhet plotësisht brenda këtij afati kohor, atëherë një përgjigje e përkohshme me shkrim do të jepet brenda 5 ditëve të punës dhe çështja do të zgjidhet përfundimisht brenda 10 ditëve të punës.
2. **Niveli i dytë:** Pas nivelit të parë të zgjidhjes së kontestit, nëse çështja nuk është zgjidhur ende, atëherë ankesa/t, së bashku me dëshmitë përkatëse, duhet t'i përcillen me shkrim Komisionit komunal të aksionarëve përkatës. Ankuesit do t'i jepet një shqyrtim përfundimtar dhe një përgjigje me shkrim brenda 10 ditëve të punës.
3. **Niveli i tretë:** Nëse asnjë zgjidhje nuk mund të arrihet midis NPL "Përparimi" dhe komunës, çështja duhet të iniciohet në Gjykatën Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri. Derisa të merret vendim e të qartësohet mosmarrëveshja, NPL "Përparimi" do të vazhdojë të ofrojë shërbimet në bazë të kësaj marrëveshje.

Neni 11

Ndëshkimet në rast të mos përmbushjes së marrëveshjes

1. Në rast se shërbimi i kontraktuar nuk plotëson nivelin e cilësisë së parashikuar në këtë marrëveshje, atëherë Komuna e Vushtrrisë do t'i zbrësë 5% të faturës së shërbimit.
2. Nëse e njëjta përsëritet në muajin pasues, atëherë do të aplikohet dyfishimi i ndëshkimit që do të thotë se ndëshkimi do të jetë 10% zbritje nga pagesa e faturës së shërbimit.
3. Gjatë cilësdo fazë të zgjidhjes së pakënaqësisë apo kontestit, shërbimet që ende nuk janë ofruar në shkallën e dakorduar të standardit të përcaktuar në kuadër të këtij dokumenti, mund të jenë shkas për një ndëshkim financiar që duhet të përcaktohet pas procesit të monitorimit nga komuna.
4. Derisa të merret vendim e të qartësohet mosmarrëveshja apo pakënaqësia, NPL "Përparimi" do të vazhdojë të ofrojë shërbimet në bazë të kësaj marrëveshje.

Neni 12

Rishikimi i Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje dhe të gjitha pjesët përbërëse të saj do të rishikohen sipas nevojës dhe me kërkesë të Komunës së Vushtrrisë apo NPL "Përparimi".
2. Për çdo ndryshim/ndërrim në shërbimet e ofruara që do të ndikojë gjatë implementimit të kësaj marrëveshje duhet të dakordohet nga të dyja palët.

Neni 13

Anulimi i Marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje mund të anulohet me pajtimin e të dyja palëve me shkrim ose nëse cilado palë jep njoftim me shkrim për anulimin e marrëveshjes, dy (2) muaj para se

të anulohet.

2. Nëse NPL "Përparimi" nuk i ofron shërbimet e dakorduara në përputhje me standardet e shërbimit që janë përcaktuar në këtë marrëveshje gjatë një periudhe të vazhdueshme prej 3 muajsh, kjo marrëveshje do të anulohet automatikisht dhe komuna nuk do të jetë e obliguar ta paguajë asnjë faturë të dorëzuar për shërbimet e ofruara gjatë kësaj periudhe.

Neni 14

Nënshkrimi i marrëveshjes

Kjo marrëveshje nënshkruhet në tri (3) kopje origjinale, dy (2) për komunën dhe një (1) për NPL "Përparimi".

Neni 15

Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës



Fadil Bahtiri

**Kryeshef Ekzekutiv
NPL "Përparimi" SH.A**

